



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**Dokument Parlamentar
Tiranë, më 15.07.2019**

**RAPORT
PËR**

PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR STATUSIN
E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 15.07.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, propozim i një grupi deputetësh.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Klotilda Bushka (Ferhati).

Projektligji është paraqitur si nismë e një grupi deputetësh, anëtarë të Këshillit për Legjislacionin, pas shqyrtimit që ky Këshill bazuar në nenin 87 të Rregullores së Kuvendit, i ka bërë tre vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë krijuar vakum ligjor në paketën e ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë.

Në përfundim të analizës dhe diskutimeve, si dhe bazuar në opinionin e paraqitur nga ekspertët, e caktuar nga anëtarët përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare, Këshilli për Legjislacionin vendosi të ndërmarrë nismën ligjore “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim reflektimin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese.

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar dhe paraqitur propozime për projektligjin ishin të pranishëm, znj. Fjoralba Caka, zëvendësministre e Drejtësisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie, z. Ardian Dvorani, Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I përkohshëm), z. Maksim Qoku, nënkryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe z. Ilir Toska, anëtar i këtij Këshilli; znj. Agnes Bernhard, Drejtuese e Misionit EURALIUS V dhe z.Klodian Rado, ekspert pranë këtij misioni.

II. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozim i një grupi deputetësh, sipas përcaktimeve të neneve 81, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Fusha që rregullon ky projektligj përfshihet në shkronjën “e” të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës sipas të cilës miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit “e) ligji për statusin e funksionarëve publikë”. Për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të miratimit me shumicë të cilësuar prej 3/5 (tre të pestat) e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

III. QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” vendos një sistem garancish ligjore në funksion të pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor me qëllim ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë e profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

Nëpërmjet parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” synohet:

- Garantimi i një procesi emërimi dhe promovimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të bazuar në kriteret transparente, objektive dhe meritokracie.
- Përcaktimi në mënyrë të detajuar i procedurave që sigurojnë përzgjedhjen e kandidatëve për magistratë dhe konfirmimin e tyre në karrierë, duke u bazuar në kriteret objektive e transparente.
- Sanksionimi i qartë dhe i plotë i të drejtave, detyrimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe papajtueshmërive me ushtrimin e funksionit.
- Rikonceptimi i sistemit të trajnimit vazhdues dhe të vlerësimit periodik të gjyqtarëve dhe prokurorëve për efekt karriere, duke zgjeruar e forcuar më tej kriteret objektive për matjen e aftësisë profesionale.
- Detajimi i të gjitha shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe sanksionet proporcionale në përputhje me shkeljet, duke e orientuar sistemin e përgjegjësisë disiplinore mbi kriteret sa më objektive.
- Sanksionimi i sistemit të procedimit disiplinor që parashikon mekanizma që garanton parimin e një procesi të rregullt ligjor bazuar në standartet ndërkombëtare.

Në datë 2 dhjetor 2016, Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve të Republikës së Shqipërisë dhe Unioni i Gjiqtarëve të Shqipërisë paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e disa dispozitave të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si të papajtueshëm me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese në përfundim të shqyrtim të kërkesës me vendimin nr. 34 datë 10.04.2017 ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës;
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 8; nenit 9, pika 1, shkronja “c”, fjalia e fundit, si dhe pikat 7 dhe 8; nenit 23, pika 10; nenit 26, pika 4, shkronja “b”; nenit 44, pika 1, shkronja “c”; nenit 64, pika 5; nenit 78, pika 3, shprehja “nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar “i pamjaftueshëm”” dhe pika 5, shkronja “b”, fjalia e fundit; nenit 95, pika 7, shprehja “me një nivel më të ulët sesa “mirë””; nenit 101; nenit 102; nenit 103; nenit 104; nenit

112, pika 1; nenit 141, pika 1, shprehja “*në masën që nuk cenon*” dhe shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike; nenit 152; nenit 161, pika 2, shprehja “*në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji*” dhe pika 3; nenit 162, pika 1, shprehja “*në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji*” dhe pika 6, shprehja “*në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji*”; nenit 164, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2; nenit 167, pika 3, shkronja “b”, shprehja “*në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji*”; nenit 168, pika 2, shprehja “*në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji*”, nenit 169, pika 5, fjalia e fundit dhe pika 6 e këtij neni

Projektligji propozon rregullimin dhe plotësimin e vakumit ligjor të krijuar në përmbajtjen e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, pas shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të disa neneve të këtij ligji, me vendimin nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara janë të domosdoshme me qëllim:

- Plotësimin vakumit ligjor të krijuar nga shfuqizimi i dispozitave të lidhura me shkeljet disiplinore të magjistratëve. Plotësimi i këtij vakumi ligjor është i nevojshëm për të garantuar zbatimin e parimeve të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve, bazuar në elementët e procesit të rregullt ligjor, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare;
- Garantimin e mirëfunksionimit normal dhe në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligj, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si organi përgjegjës për hetimin e shkeljeve të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët.
- Garantimin e mirëfunksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si organet përgjegjës për të vendosur në lidhje procedimin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

III.1 Përmbajtja e dispozitave të propozuara si nismë e një grupi deputetësh

1. Projektligjit ka si qëllim plotësimin e vakumit të krijuar nga shfuqizimi i dispozitës, që trajton papajtueshmërinë ambientale i cili është konsideruar nga Gjykata Kushtetuese si një parashikim që kufizon karrierën e magjistratit, tej urdhërimit të nenit 143 të Kushtetutës.

Qëllimi i dispozitës së propozuar është që Këshillat të shmangin papajtueshmërinë ambientale, sa më shumë që të jetë e mundur kur të vendosin për hapat e karrierës së magjistratëve. Kjo pasi, bazuar në nenin 147/a të Kushtetutës, Këshilli është organi kompetent për karrierën e magjistratit. Dispozita e propozuar parashikon gjithashtu të drejtën e Këshillit për të vendosur rregulla të mëtejshme, duke synuar garantimin e një sistemi efikas të drejtësisë, që gëzon besimin e publikut dhe siguron pavarësinë dhe paanësinë e magjistratëve. Në funksion të parimit të ligjshmërisë rastet e papajtueshmërisë ambientale janë përcakuar në mënyrë të detajuar në përmbajtjen e dispozitës.

Nëpërmjet këtij propozimi Këshilli është i detyruar të shmangë papajtueshmërinë ambientale bazuar në dy kritere të rëndësishme: a) kriterin e proporcionalitetit b) moscënimin e të drejtës për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit.

2. Projektligji propozon ndryshimin e pikave 7 dhe 8 të nenit 9 të ligjit bazë. Këto paragrafë të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese parashikonin detyrimin e

magjistratëve për të njoftuar kryetarin përkatës, në rastin e veprimtarive jashtë funksionit që kryhen pa pagesë. Në ndryshimet e propozuara janë marrë në konsideratë argumentet e parashtruara në vendimin 34/2017, lidhur me marrëdhëniet që krijohen midis magjistratëve dhe kryetarëve, dhe paanshmërinë e magjistratëve. Magjistrati për kategorinë e veprimtarive jashtë funksionit të parashikuar në këtë paragraf nuk kërkohet të marrë miratimin e Këshillit. Angazhimi i vetëm që parashikon dispozita në këtë rast është raportimi që duhet të bëjë magjistrati pranë Këshillit, për veprimtaritë e papaguara jashtë funksionit. Detyrimi i magjistratit për të njoftuar Këshillin është në përputhje të plotë me dispozitat kushtetuese që përcaktojnë kompetencat e Këshillit në këtë drejtim.

3. Një tjetër çështjet që adresohet nëpërmjet këtij projektligji është edhe plotësimi i vakumit të krijuar nga shfuqizimi i pikës 10 të nenit 23 të ligjit. Propozimi i ri për riformulimin e kësaj pike është i rëndësishëm për dy arsye: (i) rregullon një parim të mirë vendosur të së drejtës së punës, i cili garanton që pagesa i jepet vetëm atyre që kryejnë shërbimin apo punën; (ii) përmirëson disiplinën në punë të magjistratëve. Sipas vendimit nr. 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese, dispozita e mëparshme shkelte pavarësinë e brendshme të magjistratëve bazuar në marrëdhëniet e krijuara për shkak të kompetencave, mes kryetarit dhe magjistratit për të miratuar pushimin vjetor dhe lejet e veçanta. Më konkretisht, u theksua se kompetencat e kryetarit mund të keqpërdoren për të ndikuar në veprimtarinë gjyqësore dhe të ndjekjes penale të magjistratëve. Në këtë kuptim, për të garantuar pavarësinë e magjistratëve, sugjerohet të shtohet një paragraf lidhur me të drejtën për të apeluar vendimin e kryetarit në Këshillin e Lartë Gjyqësor / të Prokurorisë. Kjo do të garantojë të drejtën e magjistratit për pushim vjetor dhe do ta mbrojë atë nga ndërhyrjet e panevojshme. Nga ana tjetër, Këshilli përmes procedurës së ankesës mund të shqyrtojë veprimtarinë e kryetarëve.
4. Bazuar në argumentimin e shprehur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e një paragrafi në nenin 26 të ligjit që trajton uljen e ngarkesës së magjistratëve, janë propozuar disa ndërhyrje në këtë nen. Vendimi nr. 34/2017 argumenton se disa parashikime të këtij neni nuk janë në përputhje me nenin 138 të Kushtetutës. Formulimi i ri qartëson faktin që arsyeja për kërkesën e uljes së ngarkesës në punë bazohet në vullnetin e lirë të magjistratit, dhe që është një privilegj dhe jo domosdoshmëri për magjistratin për rrjedhje nuk kemi ulje të pagës por vetëm përshtatje të saj me veprimtarinë që realizohet nga magjistrati. Nuk ekziston rreziku i abuzimit, duke qenë se Këshillat kanë diskrecionin dhe mund të japin pëlqimin vetëm nëse ulja e ngarkesës nuk cenon interesat thelbësore të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë eficiente të funksioneve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse.
5. Projektligji parashikon ndryshime në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 bazuar në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Sipas vlerësimit të dhënë në vendimin nr.34/2017, mosha e pensionit të magjistratëve duhet të garantojë sigurinë ligjore dhe duhet të miratohet me shumicë të cilësuar. Bazuar në këtë arsyetim sugjerohet që me këtë ligj të përcaktohet mosha e daljes në pension të magjistratëve. Në këtë aspekt është propozuar që mosha e daljes në pension të magjistratëve të jetë 67 vjeç, e cila merr parasysh edhe legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore. Rritja e moshës së pensionit është një prirje që vihet re edhe në vendet e tjera të BE.

6. Ndërhyrjen e propozuara në nenet 78 dhe 95 të ligjit, janë në funksion të qartësisë dhe saktësisë të dispozitës pas shfuqizimit në disa shprehjeve të parashikuara në përmbajtjen e këtyre neneve me vendimin nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

7. Dispozitat që parashikojnë shkeljet disiplinore përbëjnë edhe dispozitat më të rëndësishme të cilat plotësojnë vakumin ligjor të krijuar në Kreun e shkeljeve disiplinore.

Sipas argumentimit të dhënë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese 34/2017, formulimi i shkeljeve disiplinore nuk i plotësonte kriteret kushtetuese për qartësi, qëndrueshmëri dhe efektivitet dhe terminologjia dhe teknikat legjislativë të përdorura në hartimin e tyre ngritën dyshime serioze për kuptimin e tyre, gjë që mund të çonte në pasoja serioze negative për statusin e magjistratëve.

Në reflektim të argumentit të dhënë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, dispozitat e shkeljeve disiplinore u rishikuan për të rritur qartësinë dhe për t'i thjeshtuar ato duke hequr, riformuluar dhe ndryshuar dispozitat e mëparshme. Struktura e neneve të mëparshme u mbajt për të siguruar konceptin e procedurës disiplinore dhe referencave. Një qasje tjetër do të shkelte seriozisht këtë koncept dhe do të kërkonte ndryshime thelbësore në dispozitat e tjera.

Dispozitat e reja të propozuara si nismë e anëtarëve të Këshillit për Legjislacionin, kanë trajtuar në mënyrë të qartë shkeljet disiplinore duke i ndarë ato në: shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit dhe shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale. Të katër dispozita janë përshkruar nga parimi i qartësisë dhe kuptueshmërisë së normës me qëllim që veprimet/mosveprimet dhe sjelljet që do të konsiderohen shkelje disiplinore dhe ndaj të cilave do të merren masat disiplinore të specifikohen në ligj në funksion të parimit të ligjshmërisë.

8. Në përmbajtjen e projektligjit, janë parashikuar ndryshime edhe në nenin 141 të ligjit me qëllim përshtatjen e tij me arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në vendimin 34/2017 Gjykata Kushtetuese u shpreh se dispozita e mëparshme (pika 1 e nenit 141) ishte në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt. Dispozita e propozuar parashikon përshtatjen e kufizimit të aksesit në informacion, duke parashikuar raste të qarta dhe të kufizuara kur aksesit mund të jetë i kufizuar. Rastet e përjashtimore ruajnë ekuilibrin e duhur midis të drejtës së magjistratit për një proces të rregullt ligjor gjatë procedurave disiplinore dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të palëve të treta, si dhe interesit të drejtësisë.

Propozimi për amendimin e nenit 141, shton një pikë që garanton të drejtën e magjistratëve për një proces të rregullt ligjor, pasi detyron Këshillat t'i sigurojnë magjistratit dhe përfaqësuesit e tij aksesin e plotë në dosje para marrjes së vendimit.

9. Projektligji propozon plotësimin e boshllëkut të krijuar nga shfuqizimi i nenit 152 të ligjit nr.96/2016, dispozitë që trajtonte pezullimin mbi bazë diskrecionit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese neni 152 që parashikon pezullimin mbi bazë diskrecioni, ka parashikuar raste të tjera pezullimi për magjistratin, në mungesë të delegimit të shprehur të nenit 140 të Kushtetutës, duke cenuar kështu nenin 116 të Kushtetutës.

Dispozita e propozuar në përputhje me nenin 140 pika 3 të Kushtetutës trajton pezullimin për shkak të procedimit disiplinor, duke mos parashikuar raste të reja pezullimi por duke disiplinuar në aspektin procedural këtë procedurën e pezullimit

10. Me qëllim harmonizimit të ri për ndryshimin e nenit 152 të ligjit me dispozitat e tjera ligjore që referojnë në këtë nen, janë propozuar ndryshimet edhe në nenet 153 dhe 156 të ligjit aktual, pavarësisht se këto dispozita nuk janë prekur nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

IV. PROCESI I KONSULTIMIT TË PROJEKTLIGJIT

Pas depozitimit, nismat ligjore “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i janë përcjellë për mendim Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I përkohshëm), Ministrisë së Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në nenin 93 dhe 187 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë japin mendim për projektligjet ose për çështje të tjera që mund të ndikojnë mbi sistemin gjyqësor/prokurorisë dhe të drejtësisë në përgjithësi.

Paralelisht me kërkesën për dhënien e mendimeve është ngritur edhe një grup pune me përfaqësues të institucioneve të sipërcituara nën asistencën e ekspertëve të misionit EURALIUS me qëllim:

- a. Reflektimin në përmbajtjen e dispozitave të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese të komenteve dhe sugjerimeve të Këshillave në funksion të qartësisë sa më të plotë të normave dhe garantimit të parimit të sigurisë juridike.
- b. Reflektimin e shqetësimeve më imediate që këto organe kanë hasur gjatë zbatimit të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë.

Projektligji në formën e tij integrale, bashkëlidhur këtij raporti është produkt i dakordësisë në grupin e punës.

V. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit në parim, nga relatorja u theksua rëndësia e miratimit të kësaj nisme ligjore, si domosdoshmëri për plotësimin e vakumit ligjor të krijuar nga shfuqizimi i disa dispozitave nëpërmjet vendimit nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese, por edhe për sigurimin e bazës rregullatore për ushtrimin e plotë të kompetencave nga organet e reja të sistemit të drejtësisë, bazuar në arsyetimin e dhënë në vendimet përkatëse në Gjykatës Kushtetuese.

Relatorja vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të maxhorancës dhe opozitës në këtë proces, në veçanti gjatë veprimtarisë së Këshillit për Legjislacionin në muajt Maj-Qershor, bashkëpunim i cili krijoi premisat e nevojshme për finalizimin e ndërmarrjes së nismave ligjore për reflektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë vlerësuan këtë nismë ligjore si një nevojë për garantimin e funksionimit normal dhe në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligj, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Përfaqësuesit e Këshillave u shprehën në mbështetje të këtyre nismave ligjore, duke theksuar domosdoshmërinë për adresimin në dispozitat e ligjit të disa çështjeve të gjykuara imediate për garantuar mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë në tërësinë e tij. Njëkohësisht ato u shprehën edhe për nevojën e ndërhyrjeve të tjera në ligj të cilat mund të propozohen në një moment të dytë.

Lidhur me këtë konstatim të përfaqësuesve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë Komisioni, duke vlerësuar rëndësinë e zbatimit të paketës së reformës në drejtësi u shpreh i gatshëm që të marrë me përparësi në shqyrtim, në vazhdim, çdo propozim që është paraqitur dhe që do të paraqitet lidhur me këto ligje dhe që nuk është adresuar në përmbajtjen e kësaj nisme.

VI. PËRMBLEDHJE E NDRYSHIMEVE TË MIRATUARA NË KOMISION

Shtesa dhe ndryshimet e miratuara në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në krahasim me variantin e depozituar si nismë e anëtarëve të Këshillit të Legjislacionit, pas rakordimit të tyre në grupin e punës të ngritur me përfaqësuesit e Këshillave nën asistencën e ekspertëve të misionit EURALIUS, janë si më poshtë:

- Në dispozitën që rregullon papajtueshmërinë ambientale në krahasim me variantin e depozituar janë bërë rregullime të natyrës teknike dhe të nevojës për të patur një harmoni me terminologjinë e ligjit nr.98/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”
- Saktësim i periudhës së raportimit në Këshillat përkatës, në rastin e ushtrimit të veprimtarive jashtë funksionit të papaguara nga magjistratët;
- Përcaktimin si shkak për uljen e ngarkesës së çështjeve edhe angazhimin e magjistratit, pa u shkeputur nga detyra, për shkak të funksionit, edhe në një detyrë tjetër (si psh zgjedhja e tij si anëtar i KED), bazuar në propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Reflektimi i sugjerimeve të KLGJ-së për një pjesë të konsiderueshme të shkeljeve disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit dhe jashtë ushtrimit të funksionit, duke përmirësuar njëkohësisht terminologjinë juridike e neneve, në funksion të parimit të qartësisë së normës në respektim të plotë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.
- Rriformulim i dispozitës përkatëse që trajton shkeljet për shkak të kryerjes së veprës penale, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë më të plotë me arsyetimin që Gjykata Kushtetuese ka bërë për masat disiplinore të lidhura me kryerjen e një vepre penale. Në këtë dispozitë është bërë një rikatëgorizim i shkeljeve, duke përcaktuar se përben shkelje dhe shkak për fillimin e procedimit disiplinor kryerja e një kundërvajtjeje penale, që cënon besimin e publikut dhe diskrediton figurën e magjistratit, ndërsa në rastin e kryerjes së një krimi, për të cilin parashikohet shkarkimi, me propozim të KLGJ-së është shtuar që procedurat disiplinore, në këtë rast të zbatohen për aq sa është e nevojshme.
- Bazuar në argumentimin e shprehur në vendimin nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese (paragrafi 75) në të cilin kjo Gjykatë arsyeton se: “Gjykata konstaton se paqartësia e normave reflektohet në tërësinë e ligjit, për rrjedhojë i sugjerohet ligjvënësit që në procesin

e rishikimit të ligjit, objekt kundërshtimi, të marrë në konsideratë nevojën për përmirësimin në tërësi të terminologjisë së përdorur në hartimin e normave ligjore, për të garantuar pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën...” janë propozuar rregullime të natyrës teknike të cilat:

- i. ose kanë ardhur si propozime të Këshillit të Lartë Gjyqësor siç është rasti i përcaktimit afateve të ankimit në gjykatën administrative të apelit (ndërhyrjet e propozuara në nenet 41, 44 dhe 96 të ligjit nr. 96/2016)
 - ii. ose janë konstatuar nga grupi i punës si rregullime të nevojshme teknike për të siguruar qartësinë e kuptimit dhe zbatimit të normës (ndërhyrjet e propozuara në nenet 43, 48, 70, 85, 91, 126 të ligjit nr.96/2016).
- Me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të rakorduar ndërmjet Këshillave dhe Shkollës së Magjistraturës u diskutua dhe u miratua shtimi i një dispozitë kalimtare e cila do të adresojë nevojën për sigurimin e funksionalitetit të gjykatave/prokurorive. Në këtë kuadër parashikohet që, deri në miratimin nga Këshillat të akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të magjistratëve dhe të realizimit të procedurave të vlerësimit sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve emërimi i kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, që sipas ligjit është parësor dhe të mos jetë i ndërvarur nga përfundimi i procedurave të transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë për magjistratët. Për shpalljen e pozicioneve të lira për kandidatët për magjistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës Këshillat do të vlerësojnë mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë dhe në veçanti, nevojat urgjente të gjykatave dhe prokurorive. Ndërkohë për magjistratët që kandidojnë gjatë kësaj periudhe kalimtare, Këshillat miratojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të tyre, për renditjen me pikë, për kriteret e vlerësimit të përvojës profesionale duke u mbështetur në parimet e transparencës, objektivitetit dhe efencës. Kjo dispozitë u diskutua edhe në mbledhjen e Komisionit, ku përfaqësuesit e Këshillit të Lartë Gjyqësor theksuan se aktualisht aktet e vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve në detyrë janë tashmë të draftuara por zbatimi i tyre kërkon kohën e nevojshme për realizimin dhe përfundimin e procedurave të vlerësimit, proces i cili do të shtynte në kohë caktimin në pozicion të magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitet 2018 dhe 2019 duke cënuar funksionalitetin e vetë sistemit të drejtësisë.
- Kjo dispozitë nuk cënon sistemin e karrierës së magjistratëve pasi parashikohet që të Këshillat të miratojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të tyre, duke u mbështetur në parimet e transparencës, objektivitetit dhe efencë. Nga ana tjetër ky parashikim tranzitor siguron mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të sistemit të drejtësisë duke garantuar dhe të drejtën kushtetuese të individëve për një proces të rregullt ligjor. Gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të këtyre akteve nënligjore, vlerësohet që Këshillat të mbajnë në konsideratë ruajtjen e një balance të drejtë ndërmjet sistemit të karrierës së magjistratëve në detyrë dhe sigurimit të funksionalitetit të sistemit të drejtësisë.

VII. PËRFUNDIME

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm miratoi projektligjin, sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti.

RELATOR

KRYETAR

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË

PROJEKTLIGJ
NR. _____/2019

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 8, ndryshon si më poshtë:

“Neni 8

Papajtueshmëria ambientale

1. Papajtueshmëria ambientale në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë.

2. Këshillat gjatë emërimit, transferimit, apo ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale sipas pikës 3 të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, efiçenca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë.

3. Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme:

a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni;

b) nëse gjyqtari që kërkon të caktohet në një gjykatë administrative të shkallës së parë, ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni, me një gjyqtar tjetër, që ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe anasjelltas;

c) nëse gjyqtari që kërkon të caktohet në seksionin civil të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni, me një gjyqtar tjetër, që ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën e shkallës së parë, si dhe anasjelltas;

ç) nëse magjistrati që kërkon të caktohet në seksionin penal të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në prokurorinë në juridiksion të kësaj gjykate, ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni me një magjistrat tjetër që ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në seksionin penal të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën dhe prokurorinë e shkallës së parë, si dhe anasjelltas.

4. Magjistrati nuk mund të caktohet në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme nëse një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni, ushtron funksionin në këto struktura.

5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati në momentin e paraqitjes së kërkesës për emërim, transferim, lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Nëse papajtueshmëria ambientale lind gjatë ushtrimit të funksionit, apo është krijuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, rregullat e parashikuara në këtë nen nuk zbatohen. Në këtë rast, me pëlqimin e tij, magjistrati mund të caktohet në një seksion tjetër.

7. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurat e zbatimit të këtij neni”.

Neni 2

Në nenin 9, pikat 7 dhe 8 ndryshohen si më poshtë:

“7. Magjistrati, pa cënuar afatet e përcaktuara dhe ushtrimin në mënyrë efëcente të funksioneve, mund të marrë pjesë në veprimtari të papaguara jashtë funksionit, pa miratimin e Këshillit, vetëm në rastet kur:

- a) vepron si përfaqësues i gjyqësorit ose prokurorisë;
- b) merr pjesë në aktivitete për çështje, të lidhura me sistemin gjyqësor ose të prokurorisë dhe bën deklarata publike të përgjithshme në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete;
- c) merr pjesë në diskutime për çështje të ligjit.

8. Magjistrati raporton, brenda 6 mujorit të parë të vitit pasardhës, në Këshill për veprimtaritë e papaguara jashtë funksionit, ku ka qenë i përfshirë në vitin paraardhës.”

Neni 3

Në nenin 23, pika 10, ndryshohet si më poshtë:

“10. Magjistrati nuk mund të kryejë mungesa në detyrë, me përjashtim të rasteve të justifikuara të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Kryetari me vendim të arsyetuar me shkrim zbret nga periudha e pushimit vjetor të të njëjtit vit, ditët e mungesës së pajustificuar. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e Kryetarit, në Këshill brenda 7 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit.

Nëse zbritja nuk mund të realizohet, kryetari njofton Këshillin, i cili merr masa që magjistrati të mos paguhet për ditët që ka munguar.”

Neni 4

Në nenin 26, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 shkronja “a” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“a) arsye të përkohshme personale ose familjare për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet.”

2. Pas shkronjën “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) kur angazhohet për shkak të funksionit të magjistratit edhe në detyra të tjera, kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

2. Në pikën 3 shkronja “a” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“a) në rastet e parashikuara në paragrafin 1 shkronja “a” të këtij neni, magjistrati kërkon ulje të ngarkesës në punë, nëse kjo nuk çënon interesat thelbësore të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë efçente të funksioneve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse;”

3. Në pikën 4 shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b. Rregulla për uljen e pagës dhe të përfitimeve të tjera, kur magjistrati ndodhet në kushtet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit;”

Neni 5

Në nenin 41 pika 2, në fund të fjalisë së parë shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje: “...brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit”.

Neni 6

Në nenin 43 pika 7, nënparagrafi “ii” “fjalët “...nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” zëvendësohen me fjalët “...nga Këshillat”.

Neni 7

Në nenin 44 pika 4, në fund të fjalisë së parë shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje: “...brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit.”

Neni 8

Në nenin 48 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1 pas fjalëve "...Prokurorinë e Përgjithshme...", shtohen fjalët "...Prokurorinë e Posaçme...".
2. Në pikën 9, shkronja "a" nënkronja "ii" fjalët "...nga Këshilli i Lartë Gjyqësor" zëvendësohen me fjalët "...nga Këshillat".

Neni 9

Në nenin 64, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:
"c) mbush moshën 67 vjeç;
2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:
"4. Mandati i Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme mbaron në fundin e muajit në të cilin mbush moshën 67 vjeç, pavarësisht viteve që ai ka qenë në detyrë në këtë pozicion."
3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:
"5. Statusi i magjistratit mbaron në fund të muajit në të cilin magjistrati mbush moshën 67 vjeç. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës."

Neni 10

Në neni 70 pika 3, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për vlerësimin e magjistratëve në skemën e delegimit ose të komanduar."

Neni 11

Në nenin 78, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

"3. Vlerësimi i përgjithshëm "shumë mirë" jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet "shumë mirë" për tri kritere dhe "mirë" për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret "aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit" dhe "etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe të prokurorisë" duhet të jenë vlerësuar "shumë mirë."

Neni 12

Në fjalinë e dytë të pikës 1, të nenit 85, fjala "...pasardhës..." zëvendësohet me fjalën "...përkatës..."

Neni 13

Në nenin 91 pika 4, pas fjalës "...vendim..." shtohet fjala "...jo përfundimtar..."

Neni 14

Në nenin 95 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 5 fjalët "...ose me vlerësim më të ulët ..." hiqen.

2. Pika 7, ndryshohet si më poshtë:

"7. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e vlerësimit të Këshillit, në Gjykatën kompetente, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale".

Neni 15

Në nenin 97 pika 6, ndryshohet si më poshtë:

"6. Magjistrati ka të drejtën e ankimit të vendimit të Këshillit për vlerësim, në gjykatën kompetente brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale."

Neni 16

Neni 101 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 101

Shkeljet disiplinore

1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:

a) kryen veprime ose mosveprime të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;

b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale.

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merren në konsideratë:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;

c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;

ç) dëmtimi ose mundësia e shkakimit të dëmtimit apo shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijjnë nga veprimi ose mosveprimi; si dhe

d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

Neni 17

Neni 102 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 102

Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit

1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si vijon:

a) Mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni, të rrethanave të tilla;

b) Paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nëse ky veprim:

(i) nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;

(ii) bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synon shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magjistrat tjetër;

(iii) mosparaqitja menjëherë e kërkesës pasi merr dijeni për shkakun;

c) Ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një magjistrati tjetër;

ç) Mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;

d) Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda, apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

dh) Veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;

e) Angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë magjistratit ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të magjistratit;

ë) Vonesa e përsëritur dhe e pajustificuar për fillimin e seancës gjyqësore ose zvarritje e hetimeve.

f) Mungesa e pajustificuar në detyrë sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;

g) Shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë;

gj) Moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;

h) Mospërmbushja pa shkaqe të pajustificuara i detyrimit për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me ligj;

i) Mosnjoftimi nga magjistrati i Kryetarit dhe Këshillit, si dhe autoriteteve kompetente sipas ligjit, për ndërhyrjet ose format e tjera të ndikimit nga magjistratët e tjerë, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektet e tjera;

j) Shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit të magjistratit ose që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar;

k) Pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ose çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij, sipas ligjit;

l) Mospërmbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve;

- ll) Bërja publike e mendimeve që janë dhënë nga vetë magjistrati ose magjistratët e tjerë gjatë procesit që nuk kanë marrë ende formën e një akti të disponueshëm për publikun;
 - m) Bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve për shtyp të magjistratit brenda kufijve të detyrës së tij;
 - n) Mosnjoftimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit;
 - nj) Mosnjoftimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit;
 - o) Mosnjoftimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimeve të funksionit, dhe për çështje për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magjistratit.
 - p) Shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Sipas parashikimeve të shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë në veçanti, por pa u kufizuar në veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, si vijon:
- a) Mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatim i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë;
 - b) Parashtrimi, i shtrembëruar i fakteve dhe rrethanave në mënyrë të dukshme në aktet e nxjerra;
 - c) Nxjerrja e akteve të paarsyetuara ose që përmbajnë në pjesën arsyetuese, vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar.
 - ç) Nxjerrja e akteve ku pjesa përshkruese-arsyetuese parashtron rrethana që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese ose që nuk kanë lidhje me të;
 - d) Marrja e vendimeve qëllimisht të paarsyetuara, si rezultat i një interesi personal ose keqdashjes;
 - dh) shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces si dhe me kryetarin, magjistratët e tjerë dhe personelin e administratës gjyqësore.

Neni 18

Neni 103 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 103

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti, por pa u kufizuar në veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit si vijon:

- a) Shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit, ose të kufizimeve për shkak të funksionimit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji;
- b) Përdorimi i statusit të magjistratit me qëllim arritjen e përfitimeve për vete ose për të tjerët;
- c) Ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit;

ç) Shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;

d) Përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;

dh) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

Neni 19

Neni 104 ndryshon si më poshtë:

“Neni 104

Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale

1. Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtje penale dhe që sipas natyrës së tyre diskreditojnë pozitën dhe figurën e magistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata.

2. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtje penale janë edhe veprime, mosveprime ose sjelljet, sipas pikës 1 të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose magjistrati është rehabilituar, ose ka përfituar nga falja apo amnistia.

3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për aq sa është e nevojshme.

Neni 20

Në nenin 126 pika 5, fjala “procedimit” zëvendësohet me fjalën “parashkrimin”.

Neni 21

Në nenin 141 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 1 i nenit 141, ndryshohet si më poshtë:

“1.Gjatë procedurës disiplinore, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre. Brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës, Këshilli i siguron magjistratit kushtet për njohjen me dosjen dhe i vë në dispozicion kopje të dokumenteve.”

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si më poshtë:

“1/1. E drejta e aksesit me dosjen, mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit, shkakton një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm ndaj interesave të mëposhtme:

- a. të drejtave themelore të një personi tjetër; ose
- b. sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar; ose
- c. parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- ç. barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

E drejta e aksesit kufizohet për aq kohë sa ekzistojnë shkaqet e mësipërme. Në çdo rast, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka akses në dosje para se Këshilli të marrë vendimin.”

Neni 22

Neni 152 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 152

Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor

1. Kur Këshilli krijon bindjen se vazhdimi në detyrë i magjistratit, për të cilin është paraqitur kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor sipas nenit 138 të këtij ligji, dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit, mund të vendosë pezullimin e tij nga detyra.

2. Pezullimi sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin sipas nenit 156 të këtij ligji.”

Neni 23

Në nenin 153 shkronjat “c” dhe “ç” shfuqizohen.

Neni 24

Neni 156 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 156

Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit

1. Pezullimi i magjistratit i parashikuar në nenet 151 dhe 152 të këtij ligji, vendoset për një periudhë të caktuar kohe dhe nuk mund të vazhdojë nëse arsyet e pezullimit të parashikuara në këto nene pushojnë së ekzistuari.

2. Këshilli kryesisht, ose me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo të magjistratit, mund të rishikojë pezullimin e parashikuar në nenet 151 dhe 152 të këtij ligji dhe vendos sipas rastit:

- a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
- b) revokimin e pezullimit; ose

c) lënien në fuqi të pezullimit.

Nen 25

Dispozitë kalimtare

1. Deri në miratimin nga Këshillat të akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të magistratëve dhe të realizimit të procedurave të vlerësimit sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magistratëve, emërimi i kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, që sipas ligjit është parësor nuk do të ndërvoaret nga përfundimi i procedurave të transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë për magistratët.

2. Për shpalljen e pozicioneve të lira për kandidatët për magistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në çdo rast Këshillat vlerësojnë mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë dhe në veçanti, nevojat urgjente të gjykatave dhe prokurorive në këndvështrim të funksionalitetit të tyre.

3. Për procedurat e transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë të magistratëve që kandidojnë gjatë kësaj periudhe kalimtare, Këshillat miratojnë dhe zbatojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të tyre; për kriteret e renditjes së magistratëve me pikë të barabarta vlerësimi; për kriteret e vlerësimit të përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë dhe për procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta, të tilla që respektojnë objektivitetin, transparencën dhe efektivitetin e këtij procesi.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI